

### Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK). Vizioni i kësaj strategjie është krijimi i institucioneve transparente, me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe që garantojnë shërbim cilësor dhe të pa-korruptueshëm. Ky vizion është adoptuar në tre qasje, parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuere, ndaj korrupsionit.


Në zbatim të masave dhe aktiviteteve të qasjes ndërgjegjësuere, Ministria e Drejtësisë harton çdo vit Strategjinë e Komunikimit dhe Vizibilitetit në fushën antikorrupsion. Nëpërmjet saj, Ministria synon të arrijë audiencë të ndryshme, brenda dhe jashtë institucioneve shtetërore dhe të ndërtojë një marrëdhënie të re me qytetarët, bazuar në besimin e ndërsjellë për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit. Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

### Aktivitetet përgjatë muajt Janar, 2022

#### Komiteti Koordinator Antikorrupsion miraton Raportin e Monitorimit, korrik-shtator 2021, të Planit të Veprimit

19.01.2022. Komiteti Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, diskutoi dhe miratoi raportin e monitorimit korrik-shtator 2021, të Planit të Veprimit Antikorrupsion. Ky raport monitorimi jep një informacion të përditësuar për këtë periudhë zbatimi të Planit të Veprimit, mbi progresin e masave dhe aktiviteteve të planifikuara për të 18 objektivet e Strategjisë Antikorrupsion. Raporti evidenton në mënyrë specifike progresin e bërë në fushën e shërbimeve elektronike, rritjen e transparencës së autoriteteve publike, ecurinë e hartimit të instrumenteve të integritetit në administratën publike, bashkëpunimin ndërmjet organeve ligjzbatuese, si dhe organizimin dhe koordinimin e masave dhe aktiviteteve me karakter ndërgjegjësuere në luftën kundër korrupsionit. Për këtë periudhë zbatimi e monitorimi janë realizuar plotësisht 29 masa dhe 65 aktivitete, pjesërisht 22 masa dhe 21 aktivitete dhe nuk janë realizuar 8 masa dhe 21 aktivitete.

Raporti i Monitorimit Korrik-Shtator, 2021 mund të aksesohet në këtë link: <https://www.drejtësia.gov.al/viti2021/>



#### Institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë miratojnë plane integriteti

19.01.2022. 12 institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë përfunduan vlerësimin e riskut të integritetit. Në takimin e Komitetit Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit drejtuar nga Ministri i Drejtësisë, në prezencë të anëtarëve, zëvendësministra të linjës, partnerëve të OSHC-ve dhe organizatave të huaja u lancua përfundimi i këtij procesi. Agjencia e Trajtitit të Pronës, Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve, Shërbimi i Provës, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit, Qendra e Parandalimit për Krimet e të Miturve dhe të Rinjve, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Qendra e Botimeve Zyrtare, Agjencia Kombëtare e Falimentit dhe Komiteti Shqiptar i Birësimeve kanë tashmë një Plan institucional Integriteti. Këto instrumente antikorrupsion synojnë të rrisin performancën institucionale, transparencën dhe llogaridhënie. Planet e Integritetit përmbajnë masa dhe iniciativa rregullatore, institucionale dhe operacionale në fusha si burimet njerëzore, menaxhimi financiar dhe rregullator, transparenca dhe prokurimi publik, fusha të evidentuara me risk të lartë për korrupsion në këto institucione. Këto instrumente janë të publikuara dhe mund të aksesohen direkt në faqet e internetit të secilit prej 12 institucioneve.

#### Fillon nga zbatimi projekti i Kurrikulës Antikorrupsion në shkollat e nivelit të arsimit të mesëm të lartë, Tiranë

17.01.2022. Projekti pilot didaktiko – edukativ, kurrikula antikorrupsion, ka filluar nga zbatimi. Kjo iniciativë e Ministrisë së Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe me mbështetjen e Ambasadës së Italisë në Tiranë, bëri bashkë mësuesit e lëndës së “Qytetarisë” dhe të “Gjuhës Italiane” në shkollat “Petro Nini Luarasi”, “Asim Vokshi”, “Myslym Keta” dhe “Qemal Stafa” në kryeqytet. Në takimin e parë, stafi pedagogjik i katër shkollave u informua për rolin dhe funksionin e Ministrisë së Drejtësisë si Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit; kuadrin e ri ligjor dhe rregullator si dhe politikën e zhvillimit të luftës kundër korrupsionit përmes qasjes parandaluese, ndëshkuese e ndërgjegjësuere. Mësuesit dhe ekspertët e të dy ministrive dakordësuan për ecurinë e projektit dhe planifikimin e takimeve të dedikuara me nxënës të shkollave në ditët në vijim. Kurrikula antikorrupsion në shkollat e Tiranës do të mbështetet nga ambasada italiane me zhvillimin e aktiviteteve proaktive dhe krijuese të nxënësve në muajt mars-maj, 2022.



#### Seminar trajnues për shkrimin e politikave për Rrjetin e Pikave të Kontaktit Antikorrupsion

25-26.01.2022. Rrjeti i pikave të kontaktit antikorrupsion i përbërë nga 30 specialistë dhe punonjës të fushës së politikave, monitorimit dhe me funksione inspektuese u mbledhën në një workshop dy-ditor me temë: Shkrimi i politikave. Krijimi i politikave, analiza dhe hulumtimi i situatës prekin sektorë të ndryshëm dhe institucione të shumta të sistemit të qeverisjes së një vendi. Për këtë qëllim dhe në përmbushje të rolit të tij, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit me një bashkëpunim të frytshëm me Projektin e Asistencës Teknike të Delegacionit Evropian në Tiranë organizoi këtë seminar. Stafi i politikave antikorrupsion pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe specialistët e institucioneve qendrore thelluan njohuritë e tyre në çështje specifike si llojet e ndryshme të hulumtimit të politikave: studimi i politikave dhe analiza e politikave; identifikimi i çështjeve të politikave në lidhje me zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit; struktura e dokumentit të politikave. Në ditën e dytë të seminarit filloi puna për hartimin e tre dokumenteve të politikave me qasje parandalimi-ndëshkimi-ndërgjegjësimi, sipas strukturës së Strategjisë Kombëtare Antikorrupsion. Të tre dokumentet do të finalizohen në muajt në vijim.

#### Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit partner dhe pjesëmarrës në aktivitetet e Tirana European Youth Capital 2022

31.01.2022. Ministria e Drejtësisë është bashkuar dhe ka paraqitur propozimet e saj në aktivitetet që do të zhvillohen gjatë vitit 2022, në kuadër të vitit Tirana Kryeqyteti Evropian i të Rinjve 2022 (Tirana European Youth Capital 2022). Aktivitete kulturore, edukative, sportive, kërkimore të ndërthurur me ekspertizë juridike dhe institucionale të fushës antikorrupsion janë planifikuar të zhvillohen gjatë vitit 2022. Kampi i Integritetit, Akademia e Filmit Antikorrupsion, Të flasim për korrupsionin, Ditë pa rryshfet, Besimi i publikut, Fryji bilbil, janë disa prej aktiviteteve që do të zhvillohen përgjatë vitit, me fokus grupe të ndryshme, të rinj-studentë-ekspertë-artistë-sportistë-nëpunës publikë. Ministria e Drejtësisë fton të gjithë të interesuarit të jenë bashkëpunëtorë të saj në këto nisma për të rritur ndërgjegjësimin publik të luftës kundër korrupsionit.

